

LEJET E NDËRTIMIT

T2 - 2026

Botimi i statistikave mbi lejet e ndërtimit mbështetet aktualisht vetëm në të dhënat e siguruar nga bashkitë, të cilat janë autoritetet kryesore për dhënien dhe raportimin e këtyre lejeve. Megjithatë, VKM nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar*, përcakton se në procesin e miratimit të lejeve të ndërtimit përfshihen edhe institucione të tjera përgjegjëse, përveç bashkive. Duke qenë se ende nuk ka një raportim të standardizuar dhe të plotë nga të gjitha këto ente pranë INSTAT, të dhënat e publikuara për tremujorin e dytë bazohen vetëm në burimet bashkiake. INSTAT po punon që të gjitha institucionet përgjegjëse të përfshihen në mënyrë të unifikuar në procesin e raportimit statistikor.

Në tremujorin e dytë të vitit 2026:

- Janë miratuar 460 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, duke shënuar një rritje prej 30,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, ku u miratuan 352 leje.
- Sipërfaqja totale e parashikuar për ndërtimet e reja në këtë tremujor është 307.127 m², duke shënuar një rritje prej 10,3 %, në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2025 (278.389 m²).
- Vlera e përafërt e projekteve të miratuara (që përfshin si ndërtesat ashtu edhe punimet inxhinierike) arriti në 16,0 miliardë lekë, duke shënuar një rënie prej 13,2 %, krahasuar me një vit më parë (18,4 miliardë lekë).
- Ndërtimet për banim përbëjnë pjesën më të madhe të lejeve të reja, me 331 leje dhe sipërfaqe ndërtimi 183.202 m².
- Ndërtesat jo-rezidente (si hotele, ndërtesa tregtare dhe industriale) zënë pjesën tjetër me 129 leje ndërtimi dhe 123.925 m² sipërfaqe.

TAB.1 LEJET E NDËRTIMIT MIRATUAR PËR NDËRTESA DHE PUNIME INXHINIERIKE, T2 – 2026

Llojet e Ndërtimeve	Numër	Sipërfaqe m ²	Ndërtime të reja 000 / lekë	Rikonstruksione 000 / lekë
Gjithsej			14.110.574	1.849.064
I. Ndërtesa	460	307.127	12.726.574	626.616
1.Ndërtime për banim (rezidente)	331	183.202	8.673.871	420.185
a. Me një kat	132	14.765	547.434	218.561
b. Me dy kate	146	27.716	1.078.209	120.852
c. Me tre ose më shumë kate	52	139.248	6.871.758	80.772
d. Rezidenca për komunitetet	1	1.473	176.470	0
2.Ndërtesa të tjera (jo rezidente)	129	123.925	4.052.703	206.431
a. Hotele dhe të ngjashme	12	8.101	372.426	115.282
b. Ndërtesa për zyra	4	1.956	31.074	9.987
c. Ndërtesa tregtare	15	7.268	275.888	2.323
d. Ndërtesa industriale	39	65.380	1.812.526	42.939
e. Ndërtesa të tjera	59	41.220	1.560.789	35.900
II. Punime Inxhinierike			1.384.000	1.222.448
1. Infrastruktura e transportit; Rugë e autostrada			415.532	979.339
2. Linjat e ujësjellësave,elektrike dhe telekomunikacionit			723.119	128.797
3. Ndërtime komplekse në kantieret industriale			0	0
4. Punime të tjera inxhinierike			245.349	114.312

Burimi: Bashkitë, llogaritjet INSTAT

* Të dhënat për numrin dhe sipërfaqjen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

**Statistikat e lejeve të ndërtimit për tremujorin e dytë 2026 janë paraprake, për shkak të mos raportimit të të dhënave nga të gjithë bashkitë.

Shënim për përdoruesit:

- Të dhënat e detajuara janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT-it, në seksionin: [Ndërtimi](#)
- Në zbatim të Politikës së Trajtimit të Gabimeve, INSTAT ndërmerr pa vonesë korrigjimin e çdo gabimi të identifikuar në statistikat zyrtare të publikuara. Përdoruesit informohen në mënyrë të menjëhershme dhe transparente për korrigjimet dhe ndryshimet e reflektuara, në përputhje me parimet e paanshmërisë, transparencës dhe cilësisë së statistikave zyrtare. Politika e plotë e Trajtimit të Gabimeve është e disponueshme në adresën: <https://www.instat.gov.al/media/9577/politika-e-trajtimit-te-gabimeve.pdf>

Metodologjia

“Lejet e ndërtimit” është një publikim me frekuencë tremujore i cili ka për qëllim të paraqesë informacion mbi lejet e ndërtimit të miratuara për ndërtesa dhe punimeve inxhinierike në nivel qarku dhe vendi.

Informacioni statistikor rreth lejeve të ndërtimit të miratuara është një tregues afatshkurtër i cili paraqet zhvillimin e sektorit të ndërtimit në periudhën pasardhëse.

Treguesit kryesorë të lejeve të ndërtimit të miratuara të cilat paraqiten në këtë publikim janë:

- Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja
- Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja
- Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike

Të dhënat mbi lejet e ndërtimit të miratuara janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor i lejeve të ndërtimit grumbullohet nga zyrat rajonale të INSTAT në bashkëpunim me zyrat urbanistike të bashkive përkatëse.

Përkufizime

Leja e ndërtimit është një autorizim për të filluar punë mbi një projekt ndërtimi. Leja është faza përfundimtare për planifikimin dhe autorizimin e ndërtimit përpara fillimit të punës.

Ndërtesat janë struktura të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose objekteve. Ndërtesat klasifikohen në dy lloje të ndryshme kategorish: 1) Ndërtesa për banim (rezidente), 2) Ndërtesa të tjera (jo rezidente), ku përfshihen ndërtesat për hotele dhe të ngjashme, ndërtesa për zyra, ndërtesa industriale, ndërtesa tregtare, etj.

Sipërfaqja është hapësira gjithsej në metra katrorë ku do të vihet në zbatim projekti i miratuar.

Punime Inxhinierike janë të gjitha ndërtimet të pa klasifikuara në ndërtesa: hekurudhat, rrugë, autostrada, ura, linja ujësjellësash, linja elektrike dhe telekomunikacioni, etj.

Klienti është personi ose organi i cili kryen ndërtimin.

Burimi i të dhënave

Burim administrativ, të dhënat grumbullohen nga zyrat statistikore rajonale pranë bashkive përkatëse.